



Lajmet e Fundit: Tiranë/Goditen, nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, 2 raste të veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve



13/07/2022

Krujë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Krasta”

Operacioni, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe të kultivimit të bimëve narkotike.

Vihet në pranga një 24-vjeçar që qarkullonte me armë zjarri, në automjet.

Në vijim të operacionit, falë hetimeve të kryera, është vënë në pranga edhe një 31-vjeçar, pasi kishte kutivuar bimë narkotike.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë me municion luftarak, asgjësohen bimët narkotike që ishin kultivuar në një zonë të pyllëzuar.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, në vijim të goditjeve të njëpasnjëshme ndaj veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe asaj të kultivimit të bimëve narkotike, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas po qarkullonte me armë zjari në automjet, kanë lokalizuar, me anë të dronit, në fshatin Krastë, automjetin që drejtohej nga personi i dyshuar.

Si rezultat i ndërhyrjes së menjëhershme të shërbimeve të Policisë, në automjetin tip “Golf 5”, që drejtohej nga shtetasi H. S., 24 vjeç, u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri pistoletë me municion luftarak.

Në vijim të operacionit, si rezultat i veprimeve proaktive, u bë e mundur që në një zonë të pyllëzuar të fshatit Krastë, të zbulohet një sipërfaqje toke në të cilën ishin kultivuar bimë narkotike kanabis. Në vijim të veprimeve hetimore u arrestua në flagrancë si autor i dyshuar i kultivimit të tyre, 31-vjeçari K. S., i cili ka lidhje shoqërore me shtetasin H. S.


Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Krujë – Vijon operacioni policor i koduar “Fati i lojërave”

Korçë – Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen penalisht 2 të tjerë, për vepra të ndryshme penale ▶